



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /  
GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës  
Policijski Inspektorat Kosova  
Police Inspectorate of Kosovo

---

*Raport Inspektimi Nr: 05/2014*

**KUJDESI I PUNONJËSVE POLICORË PËR AUTOMJETET  
ZYRTARE**



2014

## SHKURTESAT

DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DI	Departamenti i Inspektimeve
FO	Flota operative
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
LSKR	Ligji për Siguri në Komunikacionin Rrugor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PK	Policia e Kosovës
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
UA	Udhëzimi administrativ
ZA	Zyra e aksidenteve
ZRS	Zyra e regjistrimeve dhe sigurimeve

# PËRMBAJTJA

## 1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

## 2. HYRJE

## 3. PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE

3.1 Vlerësimi i respektimit të Doracakut 'Parimet dhe procedurat e Policisë' lidhur me pajisjet, dokumentet, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e automjeteve.

3.2 Vlerësimi i respektimit të Procedurave Standarde të Operimit të Flotës operative lidhur me regjistrimet dhe sigurimet e automjeteve policore.

3.3 Hartimi i të dhënave statistikore mbi aksidentet e trafikut me përfshirje të automjeteve policore dhe vlerësimi i faktorëve të aksidenteve, përfshirë përgjegjësitë e punonjësve policorë të përfshirë në to.

3.4 Vlerësimi i gatishmërisë së punonjësve policorë për shfrytëzimin transparent, ekonomik dhe efikas të automjeteve.

## 4. PËRFUNDIMET

## 5. REKOMANDIMET

## 1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1 IPK-ja sipas ligjit te saj, ka ndërmarr një inspektim ne fushën e komunikacionit rrugor siç parashihet ne nenin 25 pika 4.3 te ligjit te IPK-se, me temën “Kujdesi i punonjësve policor për automjetet zyrtare”. Me autorizim te Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, ky inspektim është zhvilluar për të vlerësuar kryerjen e detyrave nga zyrtarët e Stacioneve Policore dhe zyrtarët e Flotës Operative të PK-së në përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare të PK-së.

1.2 Inspektimit në këtë fushë i ka paraprirë faza hulumtuese e cila ka filluar me datë 20.02.2014, si dhe hartimi i programit inspektues përfshirë edhe përzgjedhjen e metodologjisë së punës. Programi i punës inspektuese ka paraparë fillimin e aktivitetit inspektues në terren prej datës 28 mars deri më 02 maj 2014.

1.3 Periudha e vlerësuar në këtë raport përfshin periudhën kalendarike një (1) vjeçare të punës, pra nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2013, ku janë inspektuar 33 Stacione Policore dhe Zyra për Regjistrim dhe Sigurim të Automjeteve në Flotën Operative të PK-së. Gjithashtu janë inspektuar 142 automjete të cilat janë në shfrytëzim nga Stacionet Policore.

1.4 Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës bëhet për të siguruar llogaridhënie, efikasitet dhe efektivitet në implementimin e ligjeve të aplikueshme, akteve nënligjore dhe procedurave tjera standarde të veprimit në fuqi. Ky raport i inspektimit përfshinë të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna për përmirësimin e gjendjes se gjetur.

1.5 Te gjeturat tregojnë se në fushën e kontrollit, përmes menaxherëve, mbikëqyrësve dhe zyrtarëve kompetent, stacionet ushtrojnë disa lloje të kontrollit të automjeteve, por disa prej tyre duhet t'i kushtojnë kujdes e rëndësi edhe kontrollit ditor të mirëmbajtjes së tyre që duhet kryhet nga përdoruesit dhe mbikëqyrësit me një mbikëqyrje të menaxherëve të stacioneve policore.

1.6 Të gjeturat e inspektimit tregojnë se në automjetet e inspektuara kishte mungesa të disa dokumenteve operacionale si: formulari i prishjes së automjetit, formulari i raportit të drejtuesit të automjetit dhe mungesa të disa pajisjeve tjera të parapara si: pajisja e radios, kutia e ndihmës së parë, aparati për fikjen e zjarrit etj.

1.7 Gjithashtu të gjeturat e inspektimit tregojnë edhe për mangësi të cilat kryesisht janë të natyrës së mosrespektimit të rregullativës së komunikacionit rrugor si: bisedat telefonike gjatë vozitjes, ndezja e dritave. Gjithashtu mosrespektim i rregulloreve është vërejtur edhe në disa raste të regjistrimit të automjeteve. Të gjitha të gjeturat në mënyrë të detajuar janë të paraqitura në kapitullin “Përmbledhja e të gjeturave”.

1.8 Lidhur me të gjeturat e paraqitura në këtë raport, IPK me datë 19.08.2014, ka mbajtur edhe takimin përmbyllës me menaxhmentin e PK-së të fushës përkatëse. Në këtë takim janë diskutuar të gjitha detajet e paraqitura në raport ku si konkluzion i këtij takimi ka dalë se të gjithë të pranishmit janë pajtuar me këto të gjetura dhe se nuk ka asnjë pikë e cila do të mundë të kontestohet.

1.9 Me datën 04.09.2014, IPK-ja ka pranuar nga Departamenti i Operacioneve, Planin e veprimit në realizimin e rekomandimeve, ku është dhënë zotimi i menaxhmentit të PK-së për implementimin e tyre. IPK do të përcjell implementimin e këtyre rekomandimeve konform këtij plani të veprimit.

## 2. HYRJE

2.1. Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka bërë Inspektim të rregullt me temën “Kujdesi i punonjësve policor për automjetet zyrtare”. Inspektimi është funksionalizuar nga Inspektorët Policor të Departamentit të Inspektimit dhe është zhvilluar nga data 28 mars deri më 02.05.2014.

2.2. Qëllimi i organizimit dhe funksionalizimit të këtij inspektimi ka qenë:

- që të vlerësohet kujdesi i punonjësve policorë ndaj automjeteve zyrtare policore,
- të ngritë vetëdijen policore mbi përgjegjësinë në shfrytëzimin dhe ruajtjen e pronës policore (automjeteve zyrtare),
- të jepet një mendim objektiv mbi respektimin e rregullave, parimeve dhe procedurave në fuqi për shfrytëzimin dhe ruajtjen e automjeteve policore, si dhe
- të jepen rekomandime për sigurimin e mënyrës më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të automjeteve policore.

2.3. Objekt i këtij inspektimi ishte vlerësimi i kujdesit të punonjësve policorë për automjetet zyrtare, kurse subjekt i inspektimit ishin stacionet policore në kuadër të DRP-ve të Divizionit të Sigurisë Publike.

2.4. Me rastin e planifikimit të aktiviteteve në funksionalizimin e inspektimit të paralajmëruar, DI-ja ka vënë para vetes këto objektiva të inspektimit:

- Të vlerësohet respektimi i parimeve dhe procedurave të Doracakut mbi shfrytëzimin e automjeteve policore (P-10.1, i datës 15.04.2008, ndryshuar në tetor të vitit 2009), lidhur me pajisjet, dokumentet, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.
- Të vlerësohet respektimi i PSO-ve (nr. referencës DL-03, datë 30.05.2011) për FO-në lidhur me regjistrimet dhe sigurimet.
- Të hartohen të dhëna statistikore mbi aksidentet e trafikut, në të cilët janë përfshirë automjetet policore dhe mbi bazën e tyre, të vlerësohen faktorët e aksidenteve, përfshirë përgjegjësitë e punonjësve policorë të përfshirë në to.
- Të identifikohen dhe evidentohen mangësitë dhe shkeljet evidente lidhur me mos respektimin e rregullave, parimeve dhe procedurave lidhur me shfrytëzimin dhe ruajtjen e automjeteve policore.
- Të vlerësohet gatishmëria e zyrtarëve policorë në shfrytëzimin sa më transparent, ekonomik, efikas dhe të leverdishëm të automjeteve.

2.5. Periudha e mbulimit në këtë fushë të inspektimit përfshinë periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2013.

2.6. Inspektimi në këtë fushë luan rol të rëndësishëm dhe do të kontribuojë në:

- Ushttrimin e kontrollit të rreptë policor, për të siguruar shkallë të lartë transparence, ekonomizimi, efikasiteti dhe leverdie në shfrytëzimin e automjeteve.
- Ngritjen e përgjegjësisë së punonjësve policorë në shfrytëzimin dhe ruajtjen e automjeteve policore.
- Ngritjen e vetëdijes policore për të ndikuar në minimizimin e rasteve kur

automjetet policore mund të shfrytëzohen në mënyrë jo të përgjegjshme dhe jo të duhur.

- Ngritjen e besimit të qytetarëve lidhur me shfrytëzimin e mjeteve të buxhetit.

2.7. Metodologjia: Gjatë këtij inspektimi është planifikuar metodologji e punës e kombinimit të intervistave me punonjësit policor kompetent për fushën që inspektohet, kontrollimi i dosjeve të automjeteve, kontrollimi i pajisjeve dhe dokumentacionit me të cilat janë të pajisura automjetet si dhe kontrollimi i mirëmbajtjes së automjeteve. Në vazhden e nxjerrjes së informacionit të duhur, gjatë procesit inspektues janë siguruar:

- dokumente të shkruara (raporte të punës, plane të inspektimit, material inspektimi),
- informata nga plotësimi i formularëve verifikues të punës në terren, dhe
- intervista nga punonjës policorë të nivelit të lartë drejtues dhe zbatues, si në vijim:
  - Drejtorët (Zëvendës) Rajonalë të Policisë,
  - Komandantët e stacioneve policore/Mbikëqyrësit e ndërrimeve në stacione,
  - Zyrtarët e Transportit dhe Logjistikës,
  - Udhëheqësin e ZA-së në kuadër të FO-së,
  - Udhëheqësin e ZRS-së në kuadër të FO-së.
- Janë inspektuar 33 Stacione Policore të cilat janë të shtrira në kuadër të shtatë (7) Drejtorive Rajonale, si dhe janë inspektuar 142 automjete zyrtare nga 416 sa është numri i përgjithshëm i tyre i sistemuar në stacione si automjete në posedim.

2.9. Inspektimi është përqendruar në këto drejtime apo fusha kryesore:

- Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e automjeteve policore.
- Pajisja e automjeteve me pajisjet dhe dokumentet e nevojshme operationale.
- Regjistrimet dhe sigurimet e automjeteve zyrtare policore.
- Përfshirja e automjeteve policore në aksidente të trafikut.
- Respektimi i rregullave të sigurisë në trafikun rrugor.

2.11. Gjatë inspektimit të kësaj fushe të menaxhimit, inspektorët e DI-së kanë konsideruar se dokumentet në vijim do të jenë baza e duhur, në të cilën duhet mbështetur puna e tyre:

- Ligji nr. 02/L-070 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor.
- Doracakun 'Parimet dhe procedurat e Policisë'.
- Procedurat Standarde të Operimit të FO-së.
- UA nr. 31/2012-MPB, për regjistrimin e automjeteve.

### 3. PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE

#### 3.1. Vlerësimi i respektimit të Doracakut 'Parimet dhe procedurat e Policisë' lidhur me pajisjet, dokumentet, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e automjeteve policore

3.1.1. Në arritjen e objektivave të inspektimit të vëna me Programin e Punës Inspektuese, inspektimi është shtrirë në 33 stacione policore, duke përfshirë të gjitha drejtoritë rajonale policore. Në ditët kur automjetet policore i janë nënshtruar inspektimit, numri i përgjithshëm i tyre i sistemuar në stacione si automjete në posedim<sup>1</sup> ka qenë 416 sosh. Nga ky numër, jashtë funksioni<sup>2</sup> janë evidentuar 226 automjete (54.3%), derisa 190 të tjera si automjete në funksion<sup>3</sup> (45.7%). Janë kontrolluar 142 prej tyre (74.7% të numrit të përgjithshëm të automjeteve në funksion), gjersa 48 të tjera (25.3%) nuk janë kontrolluar për shkak të angazhimeve operative.

3.1.2. Janë vizituar stacionet policore dhe në bazë të Listave të automjeteve dhe Orareve ditore të patrullimeve, në prezencë të mbikëqyrësve është verifikuar prezenca e automjeteve brenda zonave të përgjegjësisë së tyre. Doracaku përcakton se automjetet e PK-së duhet të qëndrojnë në zonën e përgjegjësisë për të cilën ato janë caktuar, veç rasteve kur autorizimi merret nga autoriteti miratues (drejtori rajonal, komandanti i stacionit ose mbikëqyrësi i ndërrimit-operacioneve në terren)<sup>4</sup>.

3.1.3. Për automjetet që nuk janë ndodhur brenda zonës së përgjegjësisë së tyre, janë konsultuar autoritetet përgjegjëse që kanë mundur të miratojnë rastet që lejohen për qëllime operacionale. Nuk është hasur që të gjendet ndonjë automjet që qëndron jashtë zonës së përgjegjësisë, në përjashtim të atyre kur autoritetet përgjegjëse kanë bërë aprovimin e daljes jashtë zonës së përgjegjësisë për qëllime operacionale apo rasteve, kur automjetet janë dërguar për riparime, servisime apo kontrole teknike.

3.1.4. Sipas Doracakut, zëvendës drejtorët rajonalë për administratë dhe komandantët e stacioneve policore apo njësite janë përgjegjës për kontrollimin e përhershëm, mundësinë e përdorimit dhe mirëmbajtjen e automjetit të PK-së<sup>5</sup>. Lidhur me procedurat e mirëmbajtjes, është përcaktuar që mbikëqyrësit dhe përdoruesit e automjeteve janë përgjegjës për mirëmbajtjen ditore sipas formularit të verifikimit të automjetit<sup>6</sup>. Ky parim potencon qartë se zyrtarët policorë duhet të sigurohen se automjeti i tyre i caktuar i ka të gjitha pajisjet e duhura siç përcaktohet në listën e verifikimit të automjetit të PK-së<sup>7</sup>.

3.1.5. Stacionet ushtrojnë kontrole që ndryshojnë varësisht nga natyra se çfarë kontrollohet dhe nga cilat autoritete ndërmerren ato. Disa nga to ushtrohen nga zyrtarët për logjistikë/transport, autoriteti i kontrollit të të cilëve është deleguar nga menaxherët, kurse disa të tjera, parashihen të ushtrohen në vazhdimësi nga vet përdoruesit, drejtuesit apo mbikëqyrësit.

---

<sup>1</sup> „Automjet në posedim” është cilësuar automjeti zyrtar me të cilin është i ngarkuar stacioni policor, pavarësisht gjendjes së tij teknike.

<sup>2</sup> „Automjet jashtë funksioni” është cilësuar automjeti zyrtar i pashfrytëzueshëm (automjetet që gjenden në servis apo automjetet që ndodhen në fazën e shlyerjes apo shitjes për shkak të humbjes së vlerës).

<sup>3</sup> „Automjet në funksion” është cilësuar automjeti që është në përdorim dhe është në gjendje të duhur teknike.

<sup>4</sup> Policia e Kosovës, *Doracaku i parimeve dhe procedurave*, parimi 10.01, kapitulli D, paragrafi 5.

<sup>5</sup> Policia e Kosovës, *Doracaku i parimeve dhe procedurave*, parimi 10.01, kapitulli F, paragrafi 2.

<sup>6</sup> Policia e Kosovës, *Doracaku i parimeve dhe procedurave*, parimi 10.01, kapitulli I, paragrafi 1.

<sup>7</sup> Policia e Kosovës, *Doracaku i parimeve dhe procedurave*, parimi 10.01, kapitulli I, paragrafi 2.

3.1.6. Për të pasqyruar performancën e stacioneve në këtë fushë, në *tabelën nr. 1* të këtij raporti janë prezantuar aktivitetet apo kontrollet mbikëqyrëse të ushtruara në fushën e mirëmbajtjes së automjeteve. Inspektimi ka vërejtur se në stacione policore ushtrohen disa lloje aktivitesh mbikëqyrëse të automjeteve, kurse në mesin e tyre kontrollin e rregullt ditor me raport ditor e kryejnë mbi 63% e stacioneve policore. Kontrollet dhe raportimet javore e mujore kryhen nga të gjitha stacionet policore.

Tabela nr. 1. Llojet e aktiviteteve mbikëqyrëse të automjeteve policore në kuadër të 33 stacioneve të inspektuara (2014)				
Numri i stacioneve policore	Lloji i kontrollit dhe raportimit neper stacione			
	Kontrolli me raport ditor <sup>8</sup>	Kontrolli me raport javor <sup>9</sup>	Kontrolli me raport mujor <sup>10</sup>	Kontrolle tjera <sup>11</sup>
33	21 stacione	33 stacione	33 stacione	25 stacione
10%	63.6	100	100	75.8

3.1.7. Lidhur me respektimin e ndalesës së pirjes së duhanit janë kontrolluar automjetet dhe në rastet kur është hasur që në to është konsumuar duhan, janë regjistruar pamjet dhe janë plotësuar formularët, të cilët më pas janë nënshkruar nga palët. Doracaku rregullon se 'pirja e duhanit në automjete nuk lejohet pasi një gjë e tillë është e dëmshme për imazhin e shërbimit nga ana e publikut si dhe mirëmbajtjes së automjeteve nga brenda'. Po ashtu, Doracaku potencon se 'të gjithë ata që ndezin cigare në automjete zyrtare do të jenë subjekt i masave disiplinore'<sup>12</sup>. Rezultatet dëshmojnë se në 123 automjete (86.6%) është respektuar ndalesa për pirjen e duhanit në automjete policore, ndërsa, në 19 automjete (13.4%) janë gjetur shenja të mos respektimit të ndalesës së pirjes së duhanit në automjete, që kanë prekur 13 stacione.

3.1.8. Sipas Doracakut, artikujt vijues duhet të merren si operacional për automjetin policor: pajisja e radios, aparati zjarrfikës i kontrolluar çdo të dymbëdhjetin muaj, kutia e ndihmës së parë, goma rezervë dhe veglat për ndërrimin e saj, trekëndëshi i paralajmërimit dhe zinxhirët e borës të obligueshëm për periudhën e përcaktuar me ligjin e trafikut<sup>13</sup>. Parimi përcakton se drejtuesit dhe mbikëqyrësit e automjetit janë përgjegjës për sigurimin e dokumenteve operacionale, që të jenë në automjetin e tyre (kartela e sigurimit, formulari i mirëmbajtjes të automjetit, formulari i prishjes së automjetit, formulari i udhëtimit dhe raporti i drejtuesit të automjetit)<sup>14</sup>. Në *tabelën nr. 2* është pasqyruar në mënyrë të përgjithshme gjendja e 142 automjeteve me pajisje dhe dokumente operacionale. Kuota e përgjithshme mesatare e pajisjes së automjeteve zyrtare me artikujt dhe dokumentet operacionale, në nivel të të gjitha stacioneve policore të inspektuara arrin në 76%.

<sup>8</sup> „Kontrolli i rregullt me raport ditor” është cilësuar kontrolli i automjeteve zyrtare i ushtruar nga drejtuesit dhe mbikëqyrësit, bazuar në një procedurë të caktuar dhe që dëshmohet në formë të shkruar.

<sup>9</sup> „Kontroll me raport javor” është cilësuar kontrolli i ushtruar nga zyrtarët e mirëmbajtjes së automjeteve dhe mbikëqyrësit, përmes të cilit pasqyrohet në formë të shkruar, gjendja teknike e tyre.

<sup>10</sup> „Kontroll me raport mujor” është cilësuar kontrolli i ushtruar nga zyrtarët e mirëmbajtjes dhe mbikëqyrësit, në drejtim të mbajtjes nën kontroll efikas të shpenzimit të derivateve dhe raportimit të tyre.

<sup>11</sup> „Kontrolle tjera” janë cilësuar ato kontrolle që bëhen në periudha të ndryshme në bazë të ndonjë plani apo në ad hoc. Këto mund të jenë pjesë edhe e ndonjë inspektimi të përgjithshëm të organizuar në nivel stacioni.

<sup>12</sup> Policia e Kosovës, *Doracaku i parimeve dhe procedurave të Policisë*, parimi 10.01, kapitulli L, paragrafi 1.

<sup>13</sup> Policia e Kosovës, *Doracaku i parimeve dhe procedurave të Policisë*, parimi 10.01, kapitulli J, paragrafi 1

<sup>14</sup> Policia e Kosovës, *Doracaku i parimeve dhe procedurave të Policisë*, parimi 10.01, kapitulli K, paragrafi 1



Tabela nr. 2. Të dhëna përmblledhëse mbi performancën e stacioneve policore lidhur me gjendjen e pajisjeve dhe dokumenteve operacional ne 142 automjete policore te inspektuara											
Niveli i pajisjes/ furnizimit me artikujt dhe dokumentet operationale	Pajisjet dhe dokumentet operationale										
	Pajisja e radios	Aparati për fikje zjarri	Kutia e ndihmës së parë	Goma rezervë dhe veglat	Trekëndësh paralajmërimi	Zinxhirët e borës	Kartela e sigurimit	Formulari i mirëmbajtjes	Formulari i prishjes së aut.	Formulari i udhëtimit	Raportit i drejtuesit të automjetit
Automjete	103	133	131	138	98	26	128	142	140	142	0
Përqindja (%)	72.5	93.7	92.3	97.2	69	18.3	90.1	100	98.6	100	0

3.1.9. Gjatë inspektimit të patrullave në terren, ka ngjarë që një numër i konsiderueshëm i tyre janë hasur në lëvizje e sipër. Të interesuar të shohin nga afër respektimin e rregullave të trafikut nga vetë zyrtarët policorë, inspektorët në prezencë të menaxherëve kanë inspektuar 32 patrulla në lëvizje. Doracaku përcakton se shoferi i automjetit të PK-së duhet gjithnjë të jetë shembull pozitiv për publikun derisa drejton automjetin e PK-së dhe të respektojë të gjitha rregullat e trafikut<sup>15</sup>. Inspektorët janë përqendruar në respektimin e tri rregullave për të cilat kanë vlerësuar se do të mund të japin një vlerësim mbi respektimin e tyre. Kriter vlerësues është marrë respektimi i rregullave lidhur me ndezjen e dritave gjatë ngasjes, përdorimit të telefonit gjatë ngasjes dhe përdorimit të rripit të sigurisë. Duke iu referuar informatave nga *tabela nr. 3*, vlerësohet se ka ngecje në respektimin e rregullit mbi përdorimin e rripit të sigurisë nga zyrtarët policorë ku nga 32 vetura te inspektuara gjashtë (6) nga to, zyrtaret policor nuk kishin rrypinë e sigurisë.

Tabela nr. 3. Rezultatet e inspektimit 32 automjeteve zyrtare lidhur me respektimin e rregullave të trafikut nga zyrtarët policorë gjatë ngasjes së tyre				
Performanca e zyrtarëve policorë në trafik	Numri i patrullave në lëvizje	Kriteri matës/ rregulli		
		Përdorimi i dritave të ndezura	Përdorimi i telefonit gjatë ngasjes	Përdorimi i rripit të sigurisë
Respektimi i rregullave	32	32	31	24
Përqindja (%)	100%	100%	96.9%	75%

## 3.2. Vlerësimi i respektimit të Procedurave Standarde të Operimit të Flotës operative lidhur me regjistrimet dhe sigurimet e automjeteve

3.2.1. Janë siguruar kopje të kontrolleve teknike, sigurimeve, librezave të automjeteve dhe informatat e mangëta janë verifikuar në ZRS. Janë kontrolluar njoftimet e dërguara nga ZRS-ja, tek autoritetet rajonale. Njoftimet mbi skadimin e regjistrimeve shpërndahen tek stacionet përmes drejtorive rajonale. PSO përcakton që 'ZRS-ja duhet që para një periudhe prej 30 ditëve të lajmërojë të gjitha njësitë e PK-së për skadimin e regjistrimit dhe sigurimeve të automjeteve'<sup>16</sup>. Lidhur me azhuritetin dhe efikasitetin në përcjelljen me kohë të njoftimeve për skadim të regjistrimeve, në *tabelën 4* janë prezantuar të dhënat mbi vonesat e shkaktuara.

3.2.2. Të interesuar për efikasitetin në regjistrimin me kohë të automjeteve, është inspektuar fusha e afateve kohore. Janë siguruar librezat e qarkullimit dhe për automjetet që

<sup>15</sup> Policia e Kosovës, *Doracaku i parimeve dhe procedurave të Policisë*, parimi 10.01, kapitulli E, paragrafi 1

<sup>16</sup> Policia e Kosovës, *Procedurat Standarde të Operimit të Flotës Operative*, kapitulli III- Procedura (ZRS).

janë regjistruar me vonesë, janë siguruar konfirmimet e ZRS-së për një pjesë të vonesave që kanë rezultuar nga nënshtrimi i tyre në procedurë mirëmbajtjeje. Automjetet që nuk janë regjistruar me kohë, por që kanë qenë në servis, nuk janë përfshirë në grupin e automjeteve të regjistruara me vonesë. Neni 302 i LSKR-së përcakton se 'çdo mjet motorik, traktor, çiklomotor ose mjet bashkëngjitës, i lejohet që të merr pjesë në komunikacion rrugor nëse posedon lejen e komunikacionit të vlefshme, ndërsa mjetet të cilat janë të regjistruara në Kosovë edhe librezën e mjetit'. UA-ja për regjistrimin e automjeteve rregullon se 'kërkesa për vazhdimin e regjistrimit mund të bëhet maksimalisht 15 ditë para kalimit të afatit të regjistrimit të mëparshëm'. Sipas UA-së 'pronari i automjetit është i detyruar të bëjë vazhdimin e regjistrimit të automjetit nga data e skadimit të afatit të regjistrimit'<sup>17</sup>. Lidhur me azhuretetin dhe efikasitetin në regjistrimin me kohë të automjeteve, në *tabelën nr. 4* janë prezantuar të dhënat mbi vonesat e shkaktuara.

Tabela nr. 4. Të dhëna përmblledhëse mbi performancën policore në respektimin e procedurave lidhur me njoftimet dhe regjistrimet e automjeteve (2012-2013)				
Performanca policore	Viti 2012		Viti 2013	
	Numri <sup>18</sup>	%	Numri	%
Njoftimet me kohë	34 (106)	32.1	72 (130)	55.4
Vonesat në njoftime	72	67.9	58	44.6
Regjistrimet në kohë	81 (105)	77.1	88 (127)	69.3
Vonesat në regjistrime	24	22.9	39	30.7
Vonesat e pa arsyeshme	16	66.7	34	87.2

3.2.3. Të dhënat pasqyrojnë trendin e rënies së numrit të vonesave në njoftimin e njëjësive shfrytëzuese të automjeteve për skadimin e regjistrimit, nga ana e ZRS-së kurse në anën tjetër kemi trendin e ngritjes së numrit të vonesave në regjistrimin me kohë të automjeteve, njëjtë siç është në ngritje numri i vonesave të pa arsyeshme në regjistrimin e automjeteve policore.

### 3.3. Nxjerrja e të dhënave mbi aksidentet me përfshirje të automjeteve policore, vlerësimi i shkaktarëve të tyre, përfshirë edhe përgjegjësitë e punonjësve policor

3.3.1. Në nivel të tërë Policisë së Kosovës, në Zyrën e Aksidenteve në kuadër të Flotës Operative janë kontrolluar 599 dosje të aksidenteve/ incidenteve me përfshirje të automjeteve policore për periudhën 2012-2013 dhe është mundësuar qasja në 'Road base'<sup>19</sup> në nxjerrjen e raporteve të nevojshme. Në nivel të Policisë së Kosovës, ekziston trend i rënies prej 8% të numrit të aksidenteve/ incidenteve. Në vitin 2012, automjetet policore janë përfshirë në 312 raste, ku në 170 prej tyre (45.5%), përgjegjës të aksidenteve janë cilësuar punonjësit policorë. Në vitin 2013, automjetet policore janë përfshirë në 287 raste, ku në 143 prej tyre (50.2%), përgjegjës janë cilësuar punonjësit policorë.

3.3.2. Në nivel stacionesh ku janë inspektuar 33 stacione policore, aksidentet me përfshirje policore pasqyrojnë ngritje prej 26.3% të numrit të aksidenteve nga viti 2012 në 2013. **Tabela nr. 5** pasqyron të dhëna statistikore të aksidenteve dhe incidenteve me përfshirje të punonjësve policorë të stacioneve për periudhën krahasuese 2012-2013. Vërehet trend i ngritjes së numrit të aksidenteve dhe incidenteve me përfshirje të punonjësve policorë për dy periudhat, njëjtë siç është evident edhe trendi i ngritjes së numrit të rasteve ku shkaktarë janë cilësuar punonjësit policorë.

<sup>17</sup> MPB, *Udhëzimi Administrativ nr. 31/2012-MPB për regjistrimin e automjeteve*, neni 10, pika 3.

<sup>18</sup> Dallimi në mes numrit 106 automjeteve dhe 105 qëndron në atë se nga 106 automjete që është dashur të regjistrohen, janë regjistruar 105 sepse një prej tyre ka qenë në servis.

<sup>19</sup> 'Road base' është baza e të dhënave mbi aksidentet dhe incidentet, e administruar nga Zyra e aksidenteve.

Tabela nr. 5. Të dhëna statistikore nga 33 stacione policore të inspektuara mbi numrin e aksidenteve dhe nivelin përgjegjësish të zyrtarëve policore (2012-2013)									
Aksidentet	Viti 2012			Viti 2013			Totali (2012-2013)		
	Numri i aksid.	Zyrtar Policor		Numri i aksid.	Zyrtar Policor		Numri i aksid.	Zyrtar Policor	
		Fajtor	Jo fajtor		Fajtor	Jo fajtor		Fajtor	Jo fajtor
Numri	101	38	63	127	63	64	228	101	127
%	100	37.6	62.4	100	49.6	50.4	100	44.3	55.7

3.3.3. Janë kontrolluar dosjet e aksidenteve për të vlerësuar se sa azhure janë stacionet në raportimin e tyre. Kriter vlerësues është marrë PSO-ja që mbulon aktivitetet e Flotës Operative, sipas së cilës përcaktohet se të gjitha aksidentet në komunikacion apo dëmtimet gjatë incidenteve të automjeteve të PK-së duhet të raportohen në Flotën Operative nga njësi shfrytëzues i automjetit dhe atë në periudhë të arsyeshme kohore maksimum deri në 10 ditë pune<sup>20</sup>. *Tabela nr. 6* pasqyron performancën policore në respektimin e afateve të raportimit të aksidenteve dhe incidenteve. Nga të dhënat e prezantuara në tabelë vërehet trend negativ i ngritjes së numrit të rasteve kur raportimet e aksidenteve dhe incidenteve nuk kryhen brenda afateve të përcaktuara me PSO.

Tabela 6. Respektimi i PSO-ve lidhur me raportimin e aksidenteve/incidenteve (2012-2013)				
Performanca e stacioneve në raportimin e aksidenteve	Viti 2012		Viti 2013	
	Numri	%	Numri	%
Aksidente/incidente	101	100	127	100
Të raportuara me kohë	50	49.5	39	30.7
Të pa raportuara me kohë	51	50.5	88	69.3

3.3.4. Në kapitullin e njëjtë të PSO-së ceket se 'dokumentacioni i nevojshëm për raportimin e aksidenteve apo incidenteve duhet të përmbajë: raportin e aksidentit- incidentit, raportin e drejtuesit të automjetit dhe inicimin e brendshëm disiplinor'. Në *tabelën nr. 7* janë pasqyruar rezultatet e inspektimit mbi performancën policore në përmbajtjen e dosjeve fizike të aksidenteve dhe incidenteve. Vërehet trend pozitiv i rënies së numrit të rasteve kur dosjet fizike të aksidenteve nuk përmbajnë dëshmi mbi inicimet e brendshme disiplinore.

Tab. 7. Respektimi i PSO-së lidhur me kompletimin e dosjeve të aksidenteve/ incidenteve (2012-2013)				
Performanca e stacioneve policore	Viti 2012		Viti 2013	
	Numri	%	Numri	%
Dosje të aksidenteve të shkaktuara me faj të punonjësve policorë	38	100	63	100
Dosje fizike me dëshmi mbi inicimet e brendshme disiplinore	7	18.4	19	30.2
Dosje fizike pa dëshmi mbi inicimet e brendshme disiplinore	31	81.6	44	69.8

3.3.5. Në pamundësi për të siguruar raporte që pasqyrojnë faktorët që shkaktojnë aksidentet dhe incidentet, janë siguruar kopjet e dosjeve të aksidenteve dhe mbi bazën e tyre është nxjerrë lista e këtyre faktorëve të prezantuar si në tabelë. Sipas të dhënave, shkaktari më i shpeshtë i aksidenteve për dy periudhat vjetore është manovrimi i pa sigurt me automjet gjatë veprimit në komunikacion, që përfaqësohet me 47.4% në vitin 2012 dhe 42.9% në vitin 2013.

<sup>20</sup> Policia e Kosovës, *Procedurat Standarde të Operimit të Flotës Operative*, Kapitulli- Aksidentet.

Tabela nr. 8. Paraqitja tabelore e faktorëve të aksidenteve në nivel stacionesh policore (2012/2013)							
Nr.	Faktori (shkaktari) i aksidentit	Periudha				Totali	
		2012	%	2013	%	2012/ 2013	%
1	Manovrimi i pasigurt me automjet gjatë veprimit në komunikacion (Neni 42, 43)	18	47.4	27	42.9	45	44.6
2	Faktori i pa identifikuar	9	23.7	19	30.1	28	27.7
3	Mos respektimi i rregullave lidhur me lëvizjen e mjeteve në trafik (Neni 49, 51, 53)	3	7.9	4	6.3	7	6.9
4	Mos respektimi i rregullave lidhur me kufizimin e shpejtësisë së lejuar (Neni 54)	3	7.9	3	4.8	6	5.9
5	Mos respektimi i rregullave lidhur me mbajtjen e distancës në mes të automjeteve (Neni 126, 127)	3	7.9	1	1.6	4	3.9
6	Mos respektimi i rregullave të trafikut lidhur me ndaljen dhe parkimin e mjetit (Neni 94, 104)	-	-	3	4.8	3	3
7	Mos përshtatja e kushteve të komunikacionit në kryqëzimet e rrugëve (Neni 64)	-	-	2	3.2	2	2
8	Mos respektimi i rregullave lidhur me tejkalimin dhe anashkalimin e automjeteve (Neni 72)	1	2.63	1	1.6	2	2
9	Mos respektimi i kufizimeve, ndalimeve dhe obligimeve të shprehura përmes shenjave të komunikacionit (Neni 13)	-	-	1	1.6	1	1
10	Mos respektimi i rregullave gjatë kyçjes në komunikacion (Neni 44)	-	-	1	1.6	1	1
11	Mos respektimi i rregullave lidhur me lëshimin e mjeteve dhe dhënien e përparësisë së kalimit gjatë kyçjes në trafik (Neni 62)	-	-	1	1.6	1	1
12	Mos respektimi i rregullave të trafikut lidhur me përballë kalimin e automjeteve (Neni 68)	1	2.63	-	-	1	1
Gjithsej		38	100	63	100	101	100

### 3.4. Vlerësimi i gatishmërisë së punonjësve policorë në shfrytëzimin transparent, ekonomik dhe efikas të automjeteve

3.4.1. Prioritet gjatë inspektimit i është kushtuar edhe respektimit të rregullave në fuqi në drejtim të shfrytëzimit sa më racional të automjeteve policore. Duke iu referuar formularëve të udhëtimit që janë siguruar nga menaxherët e stacioneve policore, është konstatuar se nuk është hasur në ndonjë automjet që nuk mbanë evidencë formale mbi përdorimin, shfrytëzimin apo lëvizjen e automjetit gjatë orarit, por ajo që brengosë është se nuk i kushtohet kujdes i duhur azhurnimit të informatave që duhet të prezantohen në formular.

3.4.2. Duhet minimizuar rastet kur automjetet dalin në qarkullim pa aprovimin e autoriteteve mbikëqyrëse. Është e nevojshme të ngritet një përkushtim edhe i menaxherëve por edhe i atyre që përdorin automjetet, që me kohë ato t'i nënshtrohen një kontrolli të rregullt, me synimin që të konstatohet gjendja e duhur e tyre (pajisja me artikujt dhe dokumentet operacional, validiteti apo periudha e mbulimit me sigurim/ regjistrim, gjendja teknike dhe higjienike, etj), për t'u lejuar më pas për qarkullim në kryerjen e detyrave operacionale.

3.4.3. Kontrolli i automjeteve, raportimi i çfarëdo parregullsie dhe marrja e detyrave të përditshme policore duke prezantuar informatat e duhura në formularin standard të udhëtimit, mënjanojnë mundësinë e daljes në qarkullim të automjeteve në mënyrë të pa përgatitur. Ngritja e përkushtimit në kryerjen e kontroleve, raportimeve dhe mbajtjes së evidencave të nevojshme ngritë efikasitetin, transparencën dhe racionalitetin e shfrytëzimit të automjeteve.

## 4. PËRFUNDIMET

4.1. Në drejtim të shfrytëzimit efikas dhe mirëmbajtjes së automjeteve ushtrohen një sërë kontrollesh, diku më shumë e diku më pak. Kontrollat mujore dhe javore janë të rregullta dhe për to mbahen evidenca sa i përket gjendjes teknike të automjeteve, shpenzimit të derivateve dhe dëmtimeve eventuale. Numër i konsiderueshëm i stacioneve organizojnë edhe kontrole të kohëpaskohshme, të ushtruara sipas planeve apo në baza ad hoc. Inkurajohen stacionet që nuk praktikojnë një gjë të tillë, që të ushtrojnë këtë lloj kontrolli në mënyrë të shfrytëzimit më racional të automjeteve. Është vërejtur se jo të gjitha stacionet i kushtojnë rëndësinë e duhur mirëmbajtjes ditore. Edhe pse një numër i stacioneve policore përdorin formularë të vjetër të mirëmbajtjes ditore ose disa prej tyre improvizojnë formularë të ndryshëm, përdoruesit dhe mbikëqyrësit e 12 stacioneve (36.4%) nuk përmbushin standardin e kërkuar (*Parimet e procedurat e PK-së, parimi 10.01, kapitulli I, paragrafi 1, 2 dhe kapitulli F, paragrafi 2*).

4.2. Me gjithë rregullat dhe njoftimet për ndalimin e pirjes së duhanit në automjete, inspektimi ka vënë në pah se ato nuk respektohen sa duhet nga punonjësit policorë siç kërkohet me rregullat në fuqi. Në 19 automjete (13.4%) janë gjetur shenja të mos respektimit të ndalesës së pirjes së duhanit në automjete, që kanë prekur 13 stacione, duke rezultuar me mos përmbushje të standardit për ndalesën e pirjes së duhanit në automjete policore të paraparë me Doracak (*Parimet e procedurat e PK-së, parimi 10.01, kapitulli L, paragrafi 1*).

4.3. Bazuar në formularët e verifikimit, të gjitha automjetet e inspektuara (142) nuk kanë plotësuar tërësisht standardin mbi pajisjen me artikujt dhe dokumentet operationale (*Parimet e procedurat e PK-së, parimi 10.01, kapitulli J-pajisjet, paragrafi 1 dhe kapitulli K-dokumentet, paragrafi 1*). Bazuar në kontrollin e kryer, në 142 automjete nuk është hasur se përdoret formulari 'Raporti i drejtuesit të automjetit', kurse nga deklaratimet e menaxherëve të stacioneve por edhe të FO-së vihet në pyetje ekzistimi i këtij formulari të paraparë.

4.4. Lidhur me respektimin e rregullave të trafikut dhe ato të ngasjes së automjeteve, nga inspektimi i 32 patrullave në lëvizje është konstatuar se në një rast të vetëm është hasur kur drejtuesi i automjetit ka përdorur telefonin gjatë ngasjes, kurse në tetë (8) raste nga 32 sosh (25%) është hasur kur ngasësit e automjeteve nuk kanë përdorur rripat e sigurisë gjatë ngasjes. Në këto nëntë (9) raste, zyrtarët policorë nuk kanë përmbushur standardin e kërkuar (*Parimet e procedurat e Policisë, parimi 10.01, kapitulli E- Përgjegjësitë e vozitësit, par. 1*).

4.5. Lidhur me njoftimin e njësive shfrytëzuese për skadimin e afatit të vlefshmërisë së regjistrimeve është konstatuar se ZRS-ja në njërin anë ka plotësuar standardin e kërkuar por megjithatë, në anën tjetër, nuk ka respektuar afatet kohore të njoftimeve të bëra në pjesën më të madhe të tyre. Në 72 raste të njoftimeve të bëra për skadim të regjistrimit të automjeteve për vitin 2012, nuk është plotësuar standardi i kërkuar me PSO. Kurse në vitin 2013, këto shifra ulen në trend dhe arrijnë në 58 raste (*PSO-të e Flotës Operative, kapitulli III-Procedura, Zyra e regjistrimeve dhe sigurimeve të automjeteve*).

4.6. Sipas procedurave në fuqi, ZRS-ja ngarkon njësitë shfrytëzuese të automjeteve që të kryejnë kontrollimet teknike, për të vazhduar me procedurën e sigurimit dhe regjistrimit. Bazuar në të gjeturat, 24 automjeteve nuk iu është kryer me kohë regjistrimi dhe 16 prej tyre nuk u arsyetohen vonesat e shkaktuara. Në vitin 2013, 39 automjeteve nuk iu është kryer me kohë regjistrimi, prej tyre në 34 raste, vonesat e shkaktuara në regjistrim janë të pa

arsyeshme. Në këto 50 raste për dy periudhat nuk është plotësuar standardi i kërkuar me Udhëzimin në fuqi (*UA nr. 31/2012-MPB për regjistrimin e automjeteve, neni 10, pika 3*).

4.7. Në nivel të stacioneve ka ndodhur trend i ngritjes së numrit të aksidenteve dhe incidenteve me përfshirje policore nga 101 në 127. Në vitin 2012, përgjegjës të aksidenteve në 38 raste janë cilësuar punonjësit policorë, derisa në vitin 2013, kjo shifër sillet në 63 raste.

4.8. Në ngritje është edhe numri i rasteve që raportohen me vonesë. Është konstatuar se gjatë vitit 2012, 51 aksidente apo dëmtime nuk janë raportuar konform afateve të përcaktuara, kurse gjatë vitit 2013, një gjë e tillë nuk është bërë për 88 aksidente. Në 139 raste për dy vite nuk është përfillur standardi i kërkuar (*PSO e Flotës operative, Kapitulli-Aksidentet*).

4.9. Me gjithë faktin se PSO-ja i ngarkon njësitë shfrytëzuese të automjeteve që në rastet e raportimit të aksidenteve të kompletojnë dosjen me dokumentet e nevojshme, inspektimi ka konstatuar se në vitin 2012, 31 dosje fizike të aksidenteve/ incidenteve të shkaktuara me faj të punonjësve policorë, nuk përmbajnë dëshmi mbi iniciimet e brendshme disiplinore, derisa në vitin 2013, 44 dosje fizike nuk përmbajnë dëshmi të tilla. Në 75 dosje fizike për dy vite, nuk është përfillë standardi i kërkuar (*PSO-të e Flotës operative, kapitulli- aksidentet*)

4.10. Inspektorët kanë nxjerrë të dhëna mbi numrin e shkaktarëve të aksidenteve dhe pas analizës së kryer, kanë konstatuar se faktori më i shpeshtë i aksidenteve ka qenë ‘manovrimi i pa sigurt me automjet nga punonjësit policorë gjatë veprimit në komunikacion’. Gjatë vitit 2012 janë evidentuar 18 aksidente, derisa në vitin 2013 ky faktor ka përcjellë 27 aksidente të raportuara, të shkaktuara me fajin e punonjësve policorë.



## 5. REKOMANDIMET KRYESORE

Në drejtim të përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme të performancës së personelit të stacioneve policore dhe FO-së së PK-së, në fushën e kujdesit ndaj automjeteve zyrtare policore, IPK-ja nxjerrë për PK-në këto rekomandime kryesore:

- 1. IPK-ja i rekomandon mbikëqyrësit dhe përdoruesit e automjeteve të stacioneve t'i kushtojnë kujdesin e duhur mirëmbajtjes ditore të automjeteve duke përdorur formularë unik të kontrollit ditor, kurse menaxherëve të stacioneve, të ushtrojnë kontroll në drejtim të respektimit të procedurave të mirëmbajtjes ditore të automjeteve.*
- 2. IPK-ja i rekomandon mbikëqyrësit e stacioneve policore që të ushtrojnë kontroll në drejtim të respektimit të ndalesës për pirjen e duhanit në automjete policore, duke mos përjashtuar edhe iniciimet disiplinore ndaj shkelësve të ndalesave.*
- 3. IPK-ja i rekomandon menaxhmenteve të stacioneve policore dhe logjistikave rajonale që të sigurohen se automjetet që janë në funksion, të jenë të pajisura me pajisjet dhe dokumentet operacionale.*
- 4. IPK-ja u rekomandon drejtuesve të automjeteve që të respektojnë rregullat e trafikut (përdorimi i rripat të sigurisë gjatë ngasjes) gjatë kohës sa janë pjesëmarrës të trafikut, kurse mbikëqyrësve, të organizojnë kontrolle të kohëpaskohshme për të ngritur performancën policore në respektimin e rregullave të trafikut.*
- 5. IPK-ja i rekomandon personelit të ZRS-së së FO-së që të përkushtohet në respektimin e afateve kohore për të njoftuar në kohën e duhur njësitë shfrytëzuese të automjeteve për skadimin e regjistrimeve të tyre.*
- 6. IPK-ja i rekomandon personelit të ZRS-së dhe zyrtarëve të transportit, logjistikës dhe mirëmbajtjes së automjeteve të stacioneve që të respektojnë afatet e regjistrimit të automjeteve zyrtare policore, kurse këtyre të fundit, të kryejnë me kohë kontrollet teknike, për të proceduar me kohë me hapat tjerë të sigurimit dhe regjistrimit.*
- 7. IPK-ja u rekomandon njësitë shfrytëzuese të automjeteve që në rastet e aksidentimit të automjeteve të tyre, të raportojnë me kohë në FO.*
- 8. IPK-ja u rekomandon njësitë shfrytëzuese të automjeteve që me rastin e raportimit të aksidenteve në Flotë, të kompletojnë dosjet fizike me tërë dokumentacionin e paraparë me PSO.*

## PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE

### “Vlerësimi i Kujdesit të Zyrtarëve Policor për Përdorimin e Veturave Zyrtare të PK-së”

Nr	Rekomandimi	Prioriteti	Komentet	Plani i veprimit
1	IPK-ja i rekomandon mbikëqyrësit dhe përdoruesit e automjeteve të stacioneve t'i kushtojnë kujdesin e duhur mirëmbajtjes ditore të automjeteve duke përdorur formularë unik të kontrollit ditor, kurse menaxherëve të stacioneve, të ushtrojnë kontroll në drejtim të respektimit të procedurave të mirëmbajtjes ditore të automjeteve.	I tërë rekomandimi	Duhet filluar menjëherë.- Përgjegjës Komandantet e stacioneve dhe te njësi	Java I dhe II e muajit Shtator
2	IPK-ja i rekomandon mbikëqyrësit e stacioneve policore që të ushtrojnë kontroll në drejtim të respektimit të ndalesës për pirjen e duhanit në automjete policore, duke mos përjashtuar edhe iniciimet disiplinore ndaj shkelësve të ndalesave.	I tërë rekomandimi	Duhet filluar menjëherë - Përgjegjës komandantet e stacioneve	Java e I e shtatorit
3	IPK-ja i rekomandon menaxhmenteve të stacioneve policore dhe logjistikave rajonale që të sigurohen se automjetet që janë në funksion, të jenë të pajisura me pajisjet dhe dokumentet operacionale.	I tërë rekomandimi	Duhet filluar menjëherë-Pergje Loxh. rajonale	Muaji Shtator
4	IPK-ja u rekomandon drejtuesve të automjeteve që të respektojnë rregullat e trafikut (përdorimi i rripat të sigurisë gjatë ngasjes) gjatë kohës sa janë pjesëmarrës të trafikut, kurse mbikëqyrësve, të organizojnë kontrole të kohëpaskohshme për të ngritur performancën policore në respektimin e rregullave të trafikut.	I tërë rekomandimi	Duhet filluar menjëherë - Përgjegjës stafi komandues Rajonal dhe komandantet e stacioneve	Java I dhe II e muajit Shtator
5	IPK-ja i rekomandon personelit të ZRS-së së FO-së që të përkushtohet në respektimin e afateve kohore për të njoftuar në kohën e duhur njësitë shfrytëzuese të automjeteve për skadimin e regjistrimeve të tyre.	I tërë rekomandimi	Duhet filluar menjëherë	Muaji Shtator
6	IPK-ja i rekomandon personelit të ZRS-së dhe zyrtarëve të transportit, logjistikës dhe mirëmbajtjes së automjeteve të stacioneve që të respektojnë afatet e regjistrimit të automjeteve zyrtare policore, kurse këtyre të fundit, të kryejnë me kohë kontrollet teknike, për të proceduar me kohë me hapat tjerë të sigurimit dhe regjistrimit.	I tërë rekomandimi	Duhet filluar menjëherë	Muaji Shtator
7	IPK-ja u rekomandon njësi shfrytëzuese të automjeteve që në rastet e aksidentimit të automjeteve të tyre, të raportojnë me kohë në FO.	I tërë rekomandimi	Asnjë lëndë nuk do të pranohet në zyrën e aksidenteve me vonesë dhe e pa kompletuara	Java e dytë dhe tret e shtatorit
8	IPK-ja u rekomandon njësi shfrytëzuese të automjeteve që me rastin e raportimit të aksidenteve në Flotë, të kompletojnë dosjet fizike me tërë dokumentacionin e paraparë me PSO.	I tërë rekomandimi	Lëndë e pa kompletuara dhe me vonesë nuk do të pranohen pa arsyetim me shkrim.	Java e dytë tret e muajit shtator